

Nr 2350 Prot  
Date 06.7.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

**SHPLLJE  
PËR LËVIZJE PARALELE  
PRANIM NË SHËRBIM CIVIL  
NË PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

**Specialist Strehimi, niveli minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. Vendim Nr. 243, datë 18.03.2015 I ndryshuar me VKM nr. 746, datë 19.12.2018 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive Bashkia Përmet shpall procedurën për plotësimin e vendeve të lira për pozicionin :

Specialist Strehimi

Kategoria IV-3

1 vend vakant

*Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LEVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL ) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË.**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

LËVIZJE PARALELE

13.07.2026

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

20.07.2026

## **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:**

- 1- Identifikon dhe kontribuon në menaxhimin e nevojave dhe problemeve për strehim sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të Bashkisë Permet.
- 2- Rifreskon programin 10 vjeçar të strehimit, dhe harton programet 3-vjeçare bazuar në burimet financiare të bashkisë;
- 3- Identifikon sheshe ndërtimi dhe me qëllim pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatim të ligjit Nr.9232 "Për programet sociale të strehimit";
- 4- Paraqet kërkesat pranë Ministrisë që mbulon fushën e strehimit për financime, investime dhe subvencione në baze të informacionit që dërgohet brenda muajit konik të çdo viti; .
- 5- Krijon dhe administron bazen e të dhënave për familjet që përfitojnë strehim dhe të atyre që paguajnë qira;
- 6- Siguron mbledhjen e të ardhurave nga qirata e apartamenteve të banesave sociale.
- 7- Jep mandate pagesat dhe pasqyron në regjistrin e financës mandat arketimin e bankës perkatese;
- 8- Përrpilon Kontratat e Banësive Sociale në bashkëpunim me specialistin juridik dhe ben rinovirnin e tyre;
- 9- Informon periodikisht Drejtorin e Shërbimit Social për përfituesit e Banësive Sociale që janë debitore;
- 10- Kontribuon në procesin e ndërtimit, administrimit dhe rindërtimit të banesave sociale me qira;
- 11- Harton dokumentacionin për njoftimin vjetor të ministrit.
- 12- Mbulon fushën e strehimit, për ecurinë e programeve sociale të strehimit;
- 13- Zbaton ligjshmerinë mbi privatizimet që kanë lidhje me strehimin;
- 14- Përcakton banesat e pa privatizuara që kanë qenë subjekt i ligjit 7625, datë 21.12.1992 dhe ligjit nr.9321, datë 5.11.2004.
- 15- Harton dokumentacionin e dosjeve të banesave të pa privatizuara dhe ndjek procesin e privatizimit të banesave objekt i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 97, datë 03.02.2008;

- 16- Përcakton banesat që janë ndertuar me fonde nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) të cilat deri në fund të vitit 2007 rezultojnë me kontrata të pa lidhura;
- 17- Kryen kalimin e pronësive së katër banesave në pronësi të Bashkisë në bashkëpunim me EKB dhe me miratimin e ministrisë që mbulon strehimin;
- 18- Kryen përzgjedhjen në bazë të ligjit nr. 9232 për familjet që strehoen në banesat me kosto të ulët që do të strehoen në banesat në proces, të ndertuara apo të blera në treg nga EKB;

## **1 LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Bachelor" në një nga degët e Shkencave Ekonomike, Sociologji, Psikologji
- b- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze të Çertifikuara ose me Diplome
- c- Të ketë njohuri të mira të programeve kompjuterike baze

**Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar**

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

## 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Përmet dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b - Fotokopje e noterizuar e diplomës/listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

*Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në Zyrën e Administratës së Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri”, kati katërt brenda datës 13.07.2026.*

## 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

---

Në datën 14.07.2026, njësia përgjegjëse për burimet njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë listën e kandidateve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkurrimi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse për burimet njerëzore në Bashkinë Përmet, në rrugë elektronike e-mail, telefonike për shkaqet e mos kualifikimit .

## 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

---

Kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) si dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- d) Ligj nr. 22/2018 "Për strehimin social"
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 90/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore"

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
  - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
  - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al"

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **1.5 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe Stendat e Informimit publik.

## **2 PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni, duke filluar nga data 14/07/2026

## **1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a-Të zotërojë diplomë të nivelit "Bachelor" në një nga degët e shkencave ekonomike, Sociologji,Psikologji
- b-Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze te Çertifikuara ose me Diplome
- c-Te kete njohuri te mira te programeve kompjuterike baze

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
[http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate\\_jeteshkrimi\\_standard.docx](http://lgu.dap.gov.al/CVTemplate_jeteshkrimi_standard.docx)
- b - Fotokopje të diplomës . Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f – Vertetim per gjendjen gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do te behet prane Zyres se Administrates te Bashkise Permet.

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 20/07/2026**

## 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 21//07/2026, Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin Sherbimi Kombetar i Punesimit dhe ne stendat e informimit publik, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Administrates, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## 4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar
- Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr.9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës për marrëdhëniet familjare”.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## 2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Permet, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail, telefonit etj.)

## **NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE**

### **BASHKIA PERMET**